



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Dendror - Centralno Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No.	- 3082
Nr. i fq./Br. Sb./No. pg.	6 t.6 t.6
Data/Datum/Date	13.08.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR. 24/2024<sup>1</sup> PËR  
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV  
NR.16/2013 PËR RIPRODHIMIN E KAFSHËVE TË FERMËS**

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr. 24/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.16/2013 për riprodhimin e kafshëve të fermës, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 8 (paragrafi 1.4), nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.24/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE  
PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.16/2013 PËR RIPRODHIMIN E  
KAFSHËVE TË FERMËS**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.16/2013 për Riprodhimin e kafshëve të fermës me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë dhënien e lejeve dhe licencave dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike pas kryerjes së inspektimeve.

**Neni 2**

Neni 3 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

**Neni 3**

**Licencimi i importuesve të materialit riprodhues**

1. Çdo person që bën importimin e materialit riprodhues, duhet të aplikoj për licencim në Autoritetin licencues në Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari.
2. Kërkesa për licencë bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative (në vijim: LPPA).
3. Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari do të përcaktoj formën e aplikacionit i cili do të vihet në dispozicion për të interesuarit i cili është edhe në formën elektronike.
4. Kushtet për marrjen e licencës për importimin e materialit riprodhues janë:
  - 4.1. Të jetë person fizik, juridik, Organizatë Jo Qeveritare – OJQ, e cila në statusin e vet ka të rregulluar shpërndarjen e materialit biologjik në baza humanitare - dhe fermer i regjistruar në Regjistrin e fermerëve;
  - 4.2. Për personat juridik të jetë i regjistruar si biznes ose si OJQ;

4.3. Plotësimi i kushteve teknike – teknologjike përkatëse të objekteve dhe pajisjeve për ruajtjen, mbajtjen dhe transportin e materialit riprodhues sipas kushteve të përcaktuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë - AUV;

4.4. Dëshminë për përgatitjen profesionale të personelit për mbikëqyrjen e materialit riprodhues me diplomë Universitare në: Veterinari, Bioteknologji apo Zootekni;

4.5. Kopjen e kontratës me qendrën e mbarsjes, ruajtjes apo tregtimit të materialit Riprodhues.

5. Fermerët mund të importojnë kafshë të fermës për riprodhim vetëm për nevoja të fermës së tij.

6. OJQ mund të importojnë material biologjik për të shpërndarë falas dhe të njëjtin nuk mund të tregtojnë.

7. Për aprovimin e importit fermerët duhet të plotësojnë kushtet sipas paragrafit 4, nën paragrafëve 4.1, 4.2 dhe 3.3. të këtij neni.

### **Neni 3**

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet në 4 nene të veçanta 4A, 4B, 4C dhe 4D si në vijim:

#### **Neni 4A**

#### **Organi licencues dhe afati i lëshimit të licencës**

1. Agjencia me rregulloren përkatëse për organizimin e brendshëm përcakton njësinë dhe zyrtarin përgjegjës për lëshimin e licencës.

2. Pas parashtrimit të kërkesës për licencë, komisioni ose personi i autorizuar do të bëjë inspektimin e objekteve, pajisjeve dhe personelit për përgatitje profesionale dhe harton raport me shkrim për konstatimin e gjendjes faktike i cili i bashkëngjitet kërkesës për licencim.

3. Afati për vendimmarrje në lidhje me licencën është 30 ditë nga data e pranimit të kërkesës.

#### **Neni 4B**

#### **E drejta e ankesës**

1. Kundër vendimit të organit licencues lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në LPPA.

2. Organ epror që shqyrton ankesat sipas këtij neni është Komisioni i ankesave me përbërje prej 3 (tre) anëtarëve i themeluar me vendim të Ministrit të MPBZHR. Puna dhe procedura e komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

#### **Neni 4C**

#### **Pezullimi dhe anulimi i licencës**

Licenca mund të pezullohet apo anulohet nga Agjencia në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për sistemin e lejeve dhe licencave.

## **Neni 4D**

### **Pagesat për licencë**

Pagesa për marrjen e licencës është 75 €.

#### **Neni 4**

1. Neni 5 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

2. Neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ bazik në fund të fjalisë shtohet teksti si në vijim: “i cili është edhe në mënyrë elektronike në sistemin elektronik”.

3. Neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Udhëzimit Administrativ bazik në fund të fjalisë shtohet teksti si në vijim: “i cili është edhe në mënyrë elektronike në sistemin elektronik”.

#### **Neni 5**

Në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 6**

Neni 10 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 7**

Neni 11 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 8**

Neni 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 9**

Neni 13 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 10**

Neni 14 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 11**

Neni 15 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

#### **Neni 12**

Neni 16 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 13**

Neni 18 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 14**

Neni 19 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 15**

1. Neni 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 2 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ bazik fjala Ministria zëvendësohet me fjalën Agjencia.

2. Neni 20 paragrafët 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ bazik, fshihen.

### **Neni 16**

Neni 21 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 17**

Neni 22 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 18**

Neni 23 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 19**

Neni 24 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 20**

Neni 25 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 21**

Neni 26 paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 22**

Neni 27 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

### **Neni 23**

Neni 29 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

**Neni 29**  
**Pezullimi dhe anulimi i licencës**

Pezullim dhe anulimi i licencës për importuesit e materialit riprodhues dhe mbarësuesin artificialë e licencuar bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për sistemin e lejeve dhe licencave.

**Neni 24**

Neni 30 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Ministria” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

**Neni 25**

Pas nenit 30 të Udhëzimit Administrativ bazik shtohet një nen i ri 30A si në vijim:

**Neni 30A**  
**Regjistrat Elektronik**

1. Të gjithë regjistrat e përmendur në këtë Udhëzim Administrativ dhe përmbajtja e tyre krijohen edhe në mënyrë elektronike.
2. Agjencia, krijon kushtet dhe sistemet elektronike për krijimin dhe administrimin e regjistrave elektronik.

**Neni 26**  
**Hyrja ne fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Faton PEÇI**  
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

